

**VENDIM**  
**Nr. 51, datë 20.2.2023**

**MBI MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY 24” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “P”, nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 593/2 prot., datë 15.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Energy 24’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy 24” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 593 prot., datë 7.2.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Energy 24” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”; për pikën 2.4, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “a”: Konstatohet se dokumenti “Detyrimet në kohë reale” nuk është ai i lëshuar sipas kërkesës së kësaj pike të rregullores dhe në vijim do t’i kërkohej shoqërisë ta përcjellë atë në ERE, Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Germa “b”: Në përmbushje të kërkesave të kësaj pike të rregullores, t’i kërkohej shoqërisë që të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2021 në format origjinal/fotokopje të njësuar me origjinalin dhe, gjithashtu, të depozitojë pasqyrat financiare për vitet 2019 dhe 2020, të cilat mungojnë. Po ashtu shoqëria duhet të dokumentojë/depozitojë në ERE dokumentacion vërtetues (si p.sh. vërtetim llogarie bankare, apo hua/kredi) mbi disponimin nga ana e saj të vlerës financiare për të realizuar të paktën një muaj aktivitetin për të cilën kërkon të licencohet.

- Germa “c”: Shoqëria ka depozituar në ERE një plan biznesi, i cili nuk i përket ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit, por veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për këtë arsye t’i kërkohej shoqërisë të përcjellë në ERE, planin e biznesit për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në kuadër të mosplotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy 24” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**